



KUVENDI KOMITETI PËR KOMUNITETE

EKSTRAKT

nga procesverbali i mbajtur më 9 shtator 2011, në mbledhjen e XV (pesëmbëdhjetë) të Komitetit për Komunitete.

Mbledhja u mbajt në sallën e mbledhjeve nr. 31 dhe filloi në orën 11.00.

Mbledhjen e hapi z. Shaban Ahmeti, kryesues i Komitetit.

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm të gjithë anëtarët e këtij Komiteti, përkatësisht z. Burhan Blakçori, z. Nebih Behluli, z. Arbresha Hetemaj , z. Radisav Peroviq , z. Jahë Lahu dhe z. Selver Rama.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë dhe vendimmarrje.

Në mbledhje ishin të pranishëm edhe të ftuarit z. Liman Zeqiri, Zyra Komunale për Komunitetet dhe Kthim z. Reshadija Regjepagiq dhe z. Valdete Bytyqi, Ministria për Komunitete dhe Kthim, z. Fadil Babatinca, Stacioni i policisë Podujevë, z. Nexhat Sekiraqa, Policia kufitare Veriu, z. Bekim Karagjija, OSBE , z. Istvan Torok, LMT – KFOR- Hungarez, z. Shqipe Durguti, marija Joviq dhe z. Remzije Ibrahim, ICITAP – Departamenti i Drejtësisë, SHBA.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i propozuar i ditës u miratua njëzëri.

2. Shqyrtimi dhe miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 7 qershor 2011

Ekstrakti i procesverbalit u miratua njëzëri.

3. Raporti për vizitën në lagjen e sekiraqëve në fshatin Metergoc

Kryesuesi z. Shaban Ahmeti, e paraqiti fjalën e hyrjes.

z. Radisav Peroviq, fillimisht falënderoi të gjithë pjesëmarrësit të cilët më 1 korrik 2011 vizituan lagjen e sekiraqëve dhe shtoi prej asaj dite as unë, as familja ime e ngushtë e as fqinjët e mi nuk kemi pasur probleme me të cilat jemi përballur kohë më parë kur ishte ashpërsuar kontrolli në vijën kufitare dhe asnjë vizitori nuk i është lejuar kalimi duke përfshirë edhe personat të cilët kanë dashur të shkojnë për t'i vizituar të afërmit e tyre apo atyre të cilët kanë dashur të shkojnë në shtëpitë e tyre të boshatisura.

z. Arbresha Hetemaj, theksoi, po e shohim se në këtë mbledhje janë të pranishëm disa mysafirë të cilët nuk kanë marrë pjesë në mbledhjet e mëparshme. Në vazhdim u prezantuan:

z. Reshadija Regjepagiq, Ministria për Komunitete dhe Kthim

z. Valdete Bytyqi, Ministria për Komunitete dhe Kthim

z. Bekim Karagjija, OSBE

z. Remzije Ibrahim, ICITAP - – Departamenti i Drejtësisë SHBA

z. Shqipe Durguti, ICITAP – Departamenti i Drejtësisë SHBA

z. Rafet Dervisholli, Stacioni i policisë në Podujevë, udhëheqës i Njësitit për komunitete.

z. Millomir Jovanoviq, theksoi, vizita ka qenë e organizuar dhe e realizuar në mënyrën më të mirë por më e rëndësishmja është që kohëve të fundit banorët e lagjes së sekiraqëve në fshatin Metergofc nuk kanë pasur probleme dhe urojmë që edhe në të ardhmen të mbetet kështu. Me disa zyrtarë të Ministrisë për Komunitete dhe Kthim, jemi marrë vesh që të bisedojmë me përfaqësues kompetent për shqyrtimin e mundësive për hapjen e një vendkalimi kufitar të përkohshëm në afërsi të lagjes së sekiraqëve.

Ju njoftoj se më 26 dhe 27 gusht 2011 është organizuar vizita shko dhe shiko, vizitë e cila ka qenë mjaftë e suksesshme dhe me këtë rast pjesëtarët e shpërngulur të komunitetit serb kanë vizituar shtëpitë dhe pasurinë e tyre dhe disa prej tyre kanë shprehur dëshirë dhe gatishmëri që të kthehen dhe të jetojnë këtu.

z. Nebih Behluli, u pajtua me parafolësit se vizita në lagjen e sekiraqëve është realizuar në mënyrën më të mirë të mundshme dhe shtoi në të ardhmen është e nevojshme që brengat e atyre banorëve t'i adresuar në organet relevante kompetente në mënyrë që të njëjtat të zgjidhen njëherë e përgjithmonë. Është inkurajuese ajo çfarë tha z. Radisav Peroviq se banorët e asaj lagjeje tani nuk kanë shqetësime për ardhjen dhe vajtjen e vizitorëve e ne urojmë që jo vetëm në atë pjesë por kudo çoftë tjetër të mos ketë kurrfarë problemesh.

z. Burhan Bjakçori, nënvizoi, edhe unë i bashkëngjitëm vlerësimeve pozitive për vizitën e bërë komunitetit serb në lagjen e sekiraqëve dhe të gjithëve na gëzon fakti se tani ata banorë nuk përballen me disa brenga me të cilat janë përballur kohë më parë. Ne në cilësinë e Komitetit për Komunitete e kemi shqyrtuar çështjen dhe të njëjtën e kemi iniciuar për zgjidhje në organet kompetente, pra ne e kemi përmbushur obligimin tonë por edhe në të ardhmen duhet të insistojmë tek organet kompetente për zgjidhjen e përhershme të këtij problemi.

z. Radisav Peroviq, theksoi, e falënderoj z. Agim Veliun, Kryetar i Komunës dhe përfaqësuesit e KFOR-it, Stacionit të policisë në Podujevë dhe Policisë kufitare për mirëkuptimin e brengave të banorëve në lagjen e sekiraqëve, mirëpo duke u bazuar në natyrën e problemit të gjithë këta kanë thënë se kompetent për këtë çështje është Niveli qendror.

z. Reshadija Regjepagiq, nënvizoi, Komiteti për Komunitete është strukturë shumë e rëndësishme në nivel të Komunës dhe shtoi ne si Ministri për Komunitete dhe Kthim nuk jemi ftuar asnjëherë të marrim pjesë në mbledhje andaj nuk jam e informuar për punën e juaj të deritashme, por në të ardhmen do të jem pjesëmarrëse e rregullt në mbledhjet që do t'i mbani.

Kryesuesi z. Shaban Ahmeti, shprehu mendimin se për zgjidhjen e përhershme të kësaj çështjeje do të ishte mirë që z. Millomir Jovanović, zyrtar në Zyrën Komonale për Komunitete dhe Kthim dhe z. Faik Gashi, këshilltar profesional për punë të Kuvendit të shkojnë në Ministrinë për Komunitete dhe Kthim në mënyrë që bashkërisht t'i drejtohen Kabinetit të Kryeministrit – Zyrës për komunitete.

z. Arbresha Hetemaj, shprehu mendimin se do të ishte mirë që në grup me të përmendurit të jetë edhe një anëtar i Komitetit për Komunitete dhe pasi u përkrah nga të pranishmit, propozoi që ai anëtar të jetë z. Burhan Blakçori. Propozimet e dy parafolësve u miratuan njëzëri.

4. Të ndryshme

z. Jahë Lahu, theksoi, ka filluar viti i ri shkollor dhe duke u bazuar në gjendjen e rëndë sociale të komunitetit ashkalinj e rom jam i mendimit se duhet të angazhohemi që nxënësve të komuniteteve të cekura të cilët vijojnë mësimet në shkolla të mesme t'iu sigurohen librat.

Kryesuesi z. Shaban Ahmeti, parafolësin e njoftoi se ka shumë vite që iu sigurohen librat të gjithë nxënësve të komunitetit ashkalinj dhe rom duke përfshirë edhe një numër të nxënësve të komunitetit shumicë të cilët e kanë gjendjen e rënd sociale.

Mbledhja përfundoi në orën 11.50'.

**Procesverbalin e mbajti
Faik Gashi**

**Nr. 01/162-06
Podujevë,
9 shtator 2011**

**Kryesuesi i Komitetit
Shaban Ahmeti**